



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE
KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Data: 14.02.2025

Nr: 92

Ora: 12: 00

VENDIM

PËR FILLIMIN E PROCEDURËS ADMINISTRATIVE BAZUAR NË
DENONCIMIN NR. 12, DATË 12.02.2025, TË REGJISTRIT TË DENONCIMEVE,
TË INSTITUTIT TË STUDIMEVE POLITIKE/ ISP

Sot më datë 14.02.2025, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, pasi mori në shqyrtim paraprak denoncimin me:

KËRKUES: Instituti i Studimeve Politike

SUBJEKT: Zj. Elisa Spiropali
Kryetare e Kuvendit të Shqipërisë

Z. Genci Gjonçaj
Sekretar i Përgjithshëm i Kuvendit të Shqipërisë

OBJEKT: Përdorimi i burimeve publike dhe mosraportim i veprimtarisë publike

BAZA LIGJORE: Neni 91, pikat 1, shkronjat “dh”, “f” dhe “n”, dhe 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, neni 8, pika 3, të vendimit nr. 9, datë 09.03.2021, të Komisionit Rregullator

KONSTATOJ:

Instituti i Studimeve Politike më datë 12.02.2025, ka paraqitur në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) nëpërmjet nëpërmjet portalit të denoncimeve, denoncimin e administruar në regjistrin e denoncimeve me nr. 12 ID.

Nga shqyrtimi paraprak i të dhënave që përmban denoncimi si dhe dokumentat bashkëlidhur tij pretendohet si vijon:

“Kuvendi i RSH ka njoftuar se në kuadër të programit KuvendON do të ketë takime dhe diskutime me studentë të Universitetit Ismail Qemali, takime me qytetarë në bashkinë Vlorë dhe takime me të rinj gjimnazistë në bashkinë Himarë.

Data: 14.02.2025

Nr: 92
Ora: 12:00



“Për fillimin e procedurës administrative bazuar në denoncimin nr. 12, datë 12.02.2025, të regjistrin të denoncimeve, të Institutit të Studimeve Politike/ISP”

Sipas kërkesës në KQZ thuhet se Kuvend-ON është një platformë llogaridhënieje gjithëpërfshirëse, ku të rinjtë dhe qytetarët nxiten të shprehin pikëpamjet e tyre, të ndajnë përvojat dhe të shprehin shqetësimet drejtpërdrejt Kryetares së Kuvendit të Shqipërisë.

Nga të dhënat e monitorimit të aktivitetit të Kuvendit, si dhe publikimeve që vetë Kuvendi ka bërë, rezulton se në takimet e Vlorës dhe Himarës (11 shkurt 2025) aktiviteti ka qenë i natyrës politike dhe elektorale, me pjesëmarrës deputetë e zyrtarë partiakë të bashkive respektive Vlorë dhe Himarë dhe me pjesëmarrje e fjalë të z. Bledar Çuçi.

E njëjta praktikë është ndjekur nga kryetari i Kuvendit edhe në takime të tjera të këtij programi në Berat, etj, duke e përfshirë Kuvendin në aktivitete dukshëm elektorale”.

Nga sa më sipër çmohet se, ekzistojnë kushtet për t’u nisur hetimi administrativ.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenin 19, pika 1, shkronjat “dh”, “f” dhe “n”, pika 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, nenit 8, pika 3, të vendimit nr. 9, datë 9.3.2021, të Komisionit Rregullator në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve

V E N D O S:

1. Fillimin e procedurës administrative ndaj:
 - Zj. Elisa Spiropali, Kryetare e Kuvendit të Shqipërisë;
 - Z. Genci Gjonçaj, Sekretar i Përgjithshëm i Kuvendit të Shqipërisë.
2. Rezultatet e këtij vendimi i njoftohen palëve nëpërmjet adresës së postës elektronike.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI